

VENDIM
Nr. 179, datë 29.5.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME
PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE DHE EOLIKE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 10, pika 5, nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; dhe të nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur me nr. 1469 prot., datë 24.5.2023, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike”,

konstatoi se:

- Më datë 29 prill 2023 ka hyrë në fuqi ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 24/2023, në pikën 5, të nenit 10, ngarkon ERE-n me detyrimin për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila duhet të ketë të përcaktuara kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Mbështetur në pikën 37, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, “Prodhues ekzistues me përparësi” është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaike deri në 2 mw, eolik deri në 3 mw dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri në 15 mw.

- Mbështetur në pikën 2, të nenit 31, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

- Për sa më sipër, në zbatim të nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, për sa kohë nuk është miratuar një metodologji e re për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike do të vazhdojë të përdoret metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369/2017, në zbatim të ligjit nr. 7/2017, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli deri në 2 mw dhe era deri në 3 mw për prodhuesit ekzistues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike

të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM, për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- ERE, me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi do t'i drejtohet MIE-s për informacion lidhur me subjektet të cilët që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose janë pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, për vitin 2023.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti